



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR: 1

NR I VENDIMIT..: KPCC/D/A/195/2013
DATA E VENDIMIT: 18/04/2013

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

(1) Në secilën prej 18 (tetëmbëdhjetë) kërkesave të identifikuara në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur, Komisioni

vendos që

Paraqitësi i kërkesës ose mbajtësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, ka vërtetuar pronësinë për pronën e kërkuar, ose për atë pjesë të saj, ashtu si përcaktohet në vendimin individual përkatës;

(2) Në secilën prej 18 (tetëmbëdhjetë) kërkesave të referuara në paragrafin (1) më sipër, përveç kërkesave nr.. 16491, 90130, 92863, 92864, 92865, 92866, 92867 dhe 92868, Komisioni

urdhëron që

(a) Paraqitësit të kërkesës apo bartësit e së drejtës pronësore, sipas rastit, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;

(b) Pala përgjegjëse ose çdo person i cili ka uzurpuar pronën në mënyrë të paligjshme, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri; dhe

(c) Nëse pala përgjegjëse ose çdo person që ka uzurpuar pronën në mënyrë të paligjshme, i cili dështon të përmbushë urdhrin për lirim të pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona;

(3) Në secilën prej kërkesave të identifikuara në kolonat përkatëse në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të hidhen poshtë kur paraqitësit e kërkesave kërkojnë kompensim për dëmin material apo për humbjen e shfrytëzimit të pronës së kërkuar; dhe

(4) Në rastet kur ka më shumë së një pronar, vendimi dhe urdhrat e lartpërmendur nuk ndikojnë në të drejtat përkatëse të bashkëpronarëve.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlydhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të

5. Komisioni mbajti seancën e tridhjetekatërt nga 16 nga 18 prill 2013 në Prishtinë. Komisionit i janë paraqitur gjithsej 603 kërkesa për pronë bujqësore në seancën e tridhjetekatërt nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së (“Sekretaria Ekzekutive”), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante. Tri kërkesa për pronë bujqësore të cilat iu paraqitën Komisionit, u tërhoqën nga Sekretaria Ekzekutive gjatë seancës dhe dy kërkesa për pronë bujqësore u kthyen nga Komisioni. Përveç kësaj, Komisioni vendosi nëntë kërkesa, të cilat ishin pezulluar më parë në pritje të mbajtjes së seancës dëgjimore. Gjithsej 607 kërkesa për pronë bujqësore u vendosën nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesa të përfshira në këtë vendim

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës pronësore. Të gjitha kërkesat kanë të bëjnë me prona bujqësore, përfshirë arat, kullotat dhe pyjet.

8. Ky vendim zbatohet për tetëmbëdhjetë kërkesat të identifikuar në listën e bashkangjitur. Kërkesat nr. 15873, 15909 dhe 54896 kanë qenë subjekt i një vendimi² të mëparshëm të Komisionit. Megjithatë, vendimi i mëparshëm në këto kërkesa është shfuqizuar nga Komisioni për shkak të notifikimit të pasaktë të pronës së kërkuar gjatë përpunimit të kërkesës nga Sekretaria Ekzekutive ose për shkak të gabimeve të përpunimit nga Sekretaria Ekzekutive të cilat janë identifikuar pasi është marrë vendimi. Për rrjedhojë, këto kërkesë duhet të rivendoset pas notifikimit të saktë të pronës së kërkuar dhe korrigjimit të gabimeve të përpunimit. Sekretaria Ekzekutive i ka shkruar paraqitësit të kërkesës duke e informuar ata për gabimet e notifikimit dhe i ka informuar se kërkesa do të rivendoset pas notifikimit të saktë të pronës të kërkuar. Paraqitësit e kërkesës si dhe autoritetet e kadastrave përkatëse janë informuar se vendimi i mëparshëm i Komisionit është pavlerë dhe nuk mund të përdoret për qëllimet e çfarëdo transaksioni ligjor. Pjesa e mbetur prej 589 kërkesave për pronë bujqësore të trajtuara nga Komisioni gjatë seancës përfshihen në dy vendimet e tjera pikërisht vendimin KPCC/D/A/194/2013 dhe vendimin KPCC/D/A/196/2013.

9. Të tetëmbëdhjetë e përfshira në këtë vendim janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat e kërkuara ose pala që ka shprehur interes ligjor në këto prona (“pala përgjegjëse”) e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

10. Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të drejtë

zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksin e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksin e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t’u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksin I, II dhe III, respektivisht.

² Kërkesat nr. 15873 dhe 15909 janë vendosur me vendim të Komisionit KPCC/D/A/8/2008 datë 22 shkurt 2008 dhe kërkesa nr. 54896 është vendosur me vendim të Komisionit KPCC/D/A/51/2009 datë 19 gusht 2009.

pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundës i të ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodh i në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

1. Kërkesa kontestuese – mbrojtje e thjeshtë

11. Në katër kërkesat e identifikuar në pjesën A të listës së bashkangjitur, pala që ka uzurpuar pronën e kërkuar ose pala që ka shprehur interes ligjor në këtë pronë (“Pala përgjegjëse”) ose nuk ka paraqitur mbrojtje të vlefshme në përgjigje të kërkesës ose thjesht ka kërkuar të ketë lejen e paraqitësit të kërkesës për të shfrytëzuar pronën pa ofruar ndonjë dëshmi në mbështetje të pretendimeve. Në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga palët përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesat duhet të miratohen.

a. Kërkesa nr. 06670

12. Kërkesa nr. 06670, fillimisht është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposelimin e pronës së kërkuar. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur vendimin e trashëgimisë të vitit 2006 të lëshuar nga një gjykatë paralele, sipas të cilit ai ka trashëguar pronat e kërkuara në bashkëpronësi nga babai i tij i ndjerë. Megjithatë, pasi vendimi i trashëgimisë është lëshuar nga një gjykatë paralele, Komisioni nuk e konsideron atë si dëshmi të vlefshme pronësie. Më tej, në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese e cila megjithatë nuk e tregon paraqitësin e kërkesës por babain a paraqitësit të kërkesës si pronar të pronës së kërkuar. Fleta poseduese është verifikuar si e vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive. Pasi paraqitësi i kërkesës ka paraqitur vetëm dëshmi në mbështetje të së drejtës pronësore të babait të tij, kërkesa është përpunuar nga Sekretaria Ekzekutive si kërkesë e paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait ë tij të ndjerë.

13. Kur prona e kërkuar u notifikua fillimisht, pala përgjegjëse, i cili kishte uzurpuar pronën në atë kohë, pretendoi se kishte të drejta ligjore për të, duke pohuar se prona i takonte familjes së tij bazuar në një kontratë blerje të lidhur në vitin 1959. Megjithatë, pala përgjegjëse dështoi të ofrojë dëshmi në mbështetje të pohimit të tij. Pasi notifikimi fillestar ishte i pasaktë, ai u be edhe njëherë në prill 2012. Me pas, Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi palën përgjegjëse ku i kërkoj atij të paraqitë përgjigje për pronën e notifikuar saktësisht ose të tërhiqte përgjigjen e mëparshme të kërkesës. Pala përgjegjëse nuk iu përgjigj kërkesës dhe refuzoi të bashkëpunonte më tej me Sekretarinë Ekzekutive.

14. Bazuar në dëshmitë para tij, dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

b. Kërkesa nr. 07813

15. Kërkesa nr. 07813 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij të ndjerë. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposelimin e pronës së kërkuar. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një vendim trashëgimie të vitit 1996, sipas të cilit mbajtësi i së drejtës pronësore ka trashëguar gjysmën e pronës së kërkuar dhe fletën poseduese të vitit 2007, që e tregon mbajtësin e së drejtës pronësore si bashkëpronar të pronës së kërkuar. Të dy dokumentet janë verifikuar si të vërteta nga Sekretaria Ekzekutive.

16. Pala përgjegjëse pohon se ka lejen për të shfrytëzuar pronën e kërkuar. Megjithatë, pala përgjegjëse ka dështuar të ofrojë dëshmi në mbështetje të pohimit të tij.

17. Bazuar në dëshmitë para tij, dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

c. Kërkesa nr. 13653

18. Kërkesa nr. 13653 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëshortit të saj. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin e pronave të kërkuara. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese të vitit 2002, që e tregon mbajtësin e së drejtës pronësore si pronar të pronës së kërkuar. Fleta poseduese është verifikuar si e vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive.

19. Kur prona e kërkuar u notifikua fillimisht, pala përgjegjëse, i cili kishte uzurpuar pronën në atë kohë, pretendoi se kishte të drejta ligjore për të, por dështoi të paraqitë dëshmi në mbështetje të këtij pretendimi. Pasi notifikimi fillestar ishte i pasaktë, ai u bë përsëri dhe prona e kërkuar u konstatua e pa uzurpuar në rrjedhën e notifikimit të dytë.

20. Bazuar në dëshmitë para tij, dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

d. Kërkesat nr. 15873 dhe 15909

21. Kërkesa nr. 15873 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës (“Paraqitësi i parë i kërkesës”) në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i parë i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së bashkëpronësisë dhe riposedimin e pronës së kërkuar, parcelës nr. 442 dhe 443. Kërkesa nr. 15909 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës (“Paraqitësi i dytë i kërkesës”) në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i dytë i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së bashkëpronësisë dhe riposedimin e pronës së kërkuar për të njëjtën parcelë nr. 442. Komisioni vëren se paraqitësit të dytë të kërkesës i është miratuar e drejta e bashkëpronësisë për parcelën nr. 443 me vendimin e Komisionit KPCC/D/A/186/2013 më 13/02/2013. Në mbështetje të kërkesës, të dy paraqitësit e kërkesës kanë paraqitur fletën poseduese që i tregon ata si bashkëpronarë me pjesën ideale prej 1/3 të parcelës nr. 442 dhe 443. Fleta poseduese është verifikuar si e vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive.

22. Pala përgjegjëse pohon se ka lejen, e cila i është dhënë verbalisht nga paraqitësit e kërkesës, për të shfrytëzuar pronën e kërkuar. Megjithatë, kjo është mohuar nga paraqitësit e kërkesës dhe pala përgjegjëse ka dështuar të ofrojë dëshmi në mbështetje të pohimit të tij.

23. Bazuar në dëshmitë para tij, dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

e. Kërkesa nr. 23052

24. Kërkesa nr. 23052 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin e pronës së kërkuar. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një vendim trashëgimie të vitit 1985 dhe fletën poseduese të vitit 1999, që e tregon atë si bashkëpronarë e pronës së kërkuar. Të dy dokumentet janë verifikuar si të vërteta nga Sekretaria Ekzekutive.

25. Kur prona e kërkuar u notifikua në maj 2008, pala përgjegjëse, qe kishte uzurpuar pronat në atë kohë, pretendoi të drejta ligjore për të, por dështoi të paraqitë dëshmi në mbështetje të pretendimit të tij. Pasi notifikimi i para ishte i pasaktë, ai u bë edhe një herë në mars 2010. Gjatë notifikimit të dytë prona e kërkuar u konstatua e pazurpuar.

26. Bazuar në dëshmitë para tij, dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

f. Kërkesat nr. 42042 dhe 42044

27. Kërkesat nr. 42042 dhe 42044 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposelimin e pronave të kërkuara parcelat nr. 318 dhe 319. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një fletë poseduese dhe certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme që i tregon pronat e kërkuara në emër të babait të tij. Sekretaria Ekzekutive siguroi *ex officio* një vendim trashëgimie në bazë të të cilit, paraqitësi i kërkesës ka trashëguar nga babai i tij pjesën ideale prej 1/5 të parcelës nr. 318/3, të kërkuar në kërkesën nr. 42042, dhe pjesën ideale të 1/5 të parcelës nr. 319/1, 319/6 dhe 319/7, kërkuar me kërkesën nr. 42044. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës konfirmoi vlefshmërinë e vendimit të trashëgimisë duke deklaruar se parcelat përkatëse nr. 318 dhe 319 ishin ndarë si pjesë të pronave të kërkuara te cilat ishin shitur para vdekjes së babait të tij në vitin 2007.

28. Pala përgjegjëse pretendon për të drejta ligjore në pronën e kërkuar. Megjithatë, pala përgjegjëse ka dështuar të ofrojë dëshmi në mbështetje të pohimit të tij.

29. Bazuar në dëshmitë para tij, dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

g. Kërkesa nr. 50971

30. Kërkesa nr. 50971 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht vëllait të tij. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposelimin e pronës së kërkuar. Në mbështetje të kërkesës paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një fletë poseduese të vitit 2001 që e tregon pronën e kërkuar në emër të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore.

31. Pala përgjegjëse pretendon të drejta ligjore për pronën e kërkuar duke pretenduar se ai e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 1984 me anë të një kontratë informale. Megjithatë, pala përgjegjëse ka dështuar të ofrojë dëshmi në mbështetje të pohimit të tij. Me pas, Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi paraqitësin e kërkesës i cili e mohoi shitjen e pretenduar të pronës së kërkuar tek pala përgjegjëse ose ndonjë palë e tretë.

32. Bazuar në dëshmitë para tij, dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

2. Kërkesa kontestuese – të tjera

33. Në nëntë kërkesat e identifikuar në pjesën B të listës së bashkangjitur, pala apo palët që kanë uzurpuar pronat e kërkuara, ose pala që ka shprehur interes ligjor në këto prona ("pala përgjegjëse") e ka kundërshtuar vlefshmërinë e kërkesës, megjithatë Komisioni ka arritur në përfundimin se kërkesat duhet të miratohen për arsyet e përmendura më poshtë.

a. *Kërkesa nr. 54896*

34. Kërkesa nr. 54896 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës Zivan Garic (“Paraqitësi i pare i kërkesës”) në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin e pronës së kërkuar. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një fletë poseduese të viti 2007, që e tregon mbajtësin e pretenduar të së drejtës pronësore si pronar të pronës së kërkuar. Fleta poseduese është verifikuar si e vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive.

35. Paraqitësja e kërkesës Petkana Peric (“Paraqitësi i dytë i kërkesës”) ka depozituar kërkesën nr. 22874 për të njëjtën pronë duke kërkuar të drejtën pronësore dhe riposedimin e pronës së kërkuar. Paraqitësi i dytë i kërkesës pohon se ai e ka përfituar pronësinë për pronën e kërkuar me anë të kontratës për përkujdesjen jetësore të lidhur mes saj dhe nënës së saj në vitin . 1998. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të verifikojë kontratën. Më pas, Sekretaria Ekzekutive i kërkoj paraqitësit të dytë të kërkesës të ofrojë dokumente shtesë për të provuar të drejtën e pretenduar pronësore. Paraqitësi i dytë i kërkesës ka dështuar të ofrojë dokumente të tjera.

36. Nisur nga sa u tha mësipër, dhe bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

b. *Kërkesat nr. 16491, 90130, 92863, 92864, 92865, 92866, 92867 dhe 92868*

37. Kërkesat nr. 16491 dhe 90130 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës Mihajlo Stamenkovic si mbajtës i pretenduar i së drejtës pronësore. Kërkesat nr. 92863, 92864, 92865, 92866, 92867 dhe 92868 janë depozituar nga i njëjti paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht tri vëllezërve të tij. Prona e kërkuar në kërkesat nr. 16491, 92863, 92864 dhe 92865 përbehet nga parcelat nr. 196/2 dhe 197/1, me sipërfaqe prej 33 ari dhe 92 m², ndërsa prona e kërkuar në kërkesat nr. 90130, 92866, 92867 dhe 92868 përbehet nga parcelat nr. 197/3 dhe 197/6, me sipërfaqe të përgjithshme prej 29 ari dhe 75 m². Paraqitësi i kërkesës, në të gjitha kërkesat, kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin. Në mbështetje të kërkesave, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur *inter alia* një vendim trashëgimie të vitit 1994, të lëshuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë. Në bazë të vendimit të trashëgimisë, paraqitësi i kërkesës se bashku me tre vëllezërit e tij ka trashëguar pronat e kërkuara në kërkesat nr. 16491, 90130, 92863, 92864, 92865, 92866, 92867 dhe 92868 në bashkëpronësi me babain e tyre, secili prej tyre në pjesën ideale prej ¼ të pronave të kërkuara. Vendimi i trashëgimisë, është verifikuar si i vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive. Sekretaria Ekzekutive, ka verifikuar *ex officio* po ashtu se certifikatat përkatëse për të drejtat e pronës së paluajtshme janë përditësuar dhe se ato tregojnë paraqitësin e kërkesës dhe vëllezërit e tij si bashkëpronarë të pronave të kërkuara.

38. Pala përgjegjëse Selman Pajaziti (“Pala e parë përgjegjëse”) i kundërshton kërkesat nr. 16491, 92863, 92864 dhe 92865, duke pohuar se ai ka blerë 10 ari të pronës së kërkuar në vitin 1995 nga Miroslav Stamenkovic mbi bazën e një kontratë informale të blerjes me këtë të fundit. Miroslav Stamenkovic është vëllai i paraqitësit të kërkesës dhe një nga bashkëpronarët e pronave të kërkuara në bazë të vendimit të lartpërmendur të trashëgimisë. Pala e parë përgjegjëse pohon se ky transaksion është bërë në prani të dy dëshmitarëve, njëri prej të cilëve është caktuar nga pala përgjegjëse, Muharrem Ymeri.

39. Pala përgjegjëse Halil Haziri (“Pala e dytë përgjegjëse”) në kërkesat nr. 90130, 92866, 92867 dhe 92868 pretendon se e ka blerë një pjesë të pronës së kërkuar nga Miroslav Stamenkovic. Djali i palës së dytë përgjegjëse Ismet Haziri, në mbështetje të pretendimit të

lartpërmendur, ka paraqitur një parakontratë joformale më shkrim dore të vitit 2005 të lidhur mes djalit të palës së dytë përgjegjëse dhe Miroslav Stamenkovic. Megjithatë, kjo kontratë nuk e përcakton pronën e saktë të përfshirë në këtë kontratë.

40. Paraqitësi i kërkesës, në deklaratën e tij me shkrim, ka pranuar se vëllai i tij ka shitur një pjesë të pronave të kërkuara tek pala e dytë përgjegjëse, por se ai nuk dinte për hollësitë e saj. Megjithatë, kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës e ndryshoi parashtresën duke mohuar shitjen e pronave të kërkuara.

41. Gjatë seancës të 33^{te} të mbajtur në 13 shkurt 2013, Komisioni ka urdhëruar mbajtjen e një seance dëgjimore nga një prej anëtareve të tij në bazë të nenit 5.4 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Paraqitësi i kërkesës, vëllai i paraqitësit të kërkesës Miroslav Stamenkovic, palët përgjegjëse dhe dëshmitari Muharrem Ymeri i propozuar nga pala e parë përgjegjëse, u ftuan në seancën dëgjimore. Seanca dëgjimore u mbajt më 11 mars 2013 në mjediset e AKP-së në Prishtinë. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës nuk mori pjesë në seancë dëgjimore duke cekur arsyet shëndetësore dhe Miroslav Stamenkovic ndërkohe kishte ndërruar jetë, kjo e dëshmuar me certifikatën e tij të vdekjes. Dëshmitari Muharrem Ymeri po ashtu nuk mori pjesë në seance dëgjimore. Në vend të palës së dytë përgjegjëse Halil Haziri, mori pjesë djali i tij Ismet Haziri se bashku me përfaqësuesin e tij të autorizuar Bejtush Isufi.

42. Pala e parë përgjegjëse Selman Pajaziti deklaroi se ai kishte blerë 10 ari të pronës së kërkuar në kërkesat nr. 16491, 92863, 92864 dhe 92865 në vitin 1995 nga Miroslav Stamenkovic, dhe se dëshmitari Muharrem Ymeri ka qenë i pranishëm kur ai i ka paguar të hollat për pronën Miroslav Stamenkovic në shumën prej 5,000 DM. Pala e parë përgjegjëse deklaroi se ai e kujtonte se dëshmitari Muharrem Ymeri kishte kontaktuar Miroslav Stamenkovic i cili në përmbushje të kontratës informale kishte shënuar fizikisht 10 ari të parcelës përkatëse. Më tej, pala e parë përgjegjëse deklaroi se në mars të vitit 2001 ai ka ndërtuar shtëpi në pjesën e blerë të pronës së kërkuar.

43. Ismet Haziri, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, avokatit Bejtush Isufi, konfirmoi se ishte lidhur një parakontratë mes Ismet Hazirit dhe shitësit Miroslav Stamenkovic, e cila është hartuar nga përfaqësuesi i autorizuar i Ismet Hazirit, pikërisht Bejtush Isufi. Ismet Haziri përsëriti parashtresat e mëparshme dhe shpjegoi se pjesa e blerë e pronës së kërkuar është në madhësinë prej 4 ari dhe 75 m². Ai pranoi se nuk ishte bërë kurrë ndarja e duhur e parcelës përkatëse në përmbushje të kontratës së lartpërmendur pasi kjo ishte detyrimi kontraktor i shitësit, Miroslav Stamenkovic. Më tej, Ai deklaroi se kishte ndërtuar një pronë banesore në pjesën e blerë të pronës së kërkuar.

44. Komisioni i konstaton deklaratat e palëve përgjegjëse gjatë seancës dëgjimore se ata kanë blerë pjesë të pronës së kërkuar nga paraqitësi i kërkesës, si të besueshme dhe në pajtueshmëri me deklaratat e mëparshme të tyre në AKP. Më tej, Komisioni vëren se deklaratat e paraqitësit të kërkesës kanë qenë pjesërisht të papajtueshme dhe ka dështuar të kundërshtojë deklaratat e hollësishme dhe të shtjelluara të palëve përgjegjëse. Nëse paraqitësi i kërkesës do të kishte qenë në të vërtetë pronar i pronës së kërkuar përkatëse, ai duhet të kishte marrë masat të mbronte pronat pasi të dy palët përgjegjëse kanë ndërtuar pronë banesore në pronën e kërkuar.

45. Nisur nga sa u tha më sipër dhe bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konstaton se kërkesat nr. 16491, 92863, 92864 dhe 92865 duhet të miratohen në sipërfaqen prej 23 ari dhe 92 m² dhe kërkesat nr. 90130, 92866, 92867 dhe 92868 duhet të miratohen në sipërfaqen prej 25 ari. Pjesa tjetër e kërkesave duhet të refuzohet. Megjithatë, Komisioni vëren se pala e parë përgjegjëse Selman Pajaziti në kërkesat nr. 16491, 92863, 92864 dhe 92865 dhe pala e dytë

përgjegjëse Halil Haziri në kërkesat nr. 90130, 92866, 92867 dhe 92868, të referua në kolonën përkatëse të listës së bashkangjitur janë *prima facie* bashkëpronarë të ligjshëm të pronave të kërkuara respektive. Në këto rrethana, duhet të miratohet urdhër për konfirmimin e së drejtës pronësore të mbajtësit repsektiv të së drejtës pronësore në kërkesat nr. 16491, 92863, 92864 dhe 92865 dhe në kërkesat nr. 90130, 92866, 92867 dhe 92868 pa urdhër dëbimi ose formë tjetër të mjeti ndihmës ashtu si është përcaktuar më sipër.

46. Nga sa u tha më sipër, bazuar në dëshmitë që i posedon, Komisioni konstaton se në kërkesat e identifikuar në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur:

- (a) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, ka të drejtën e pronësisë në lidhje me pronën e kërkuar, apo pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;
- (b) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, në secilin rast tani nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj të pronësisë; dhe
- (c) kërkesa në secilin rast përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

47. Rrjedhimisht, pasi paraqitësi i kërkesës në secilën nga kërkesat e identifikuar në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur, kanë provuar të drejtën pronësore pronën e kërkuar dhe në mungesë të një mbrojtje të vlefshme nga ana e palëve përgjegjëse, të gjitha këto kërkesa duhet të miratohen.

3. *Kërkesa për kompensim*

48. Komisioni vëren se në disa nga kërkesat e përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave gjithashtu kërkojnë, përveç pronësisë, kompensimin për dëmin material apo humbje të shfrytëzimit, të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni i nuk ka juridiksion për kërkesat e tilla. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të hidhen poshtë.

B. *Vërejtje përmbledhëse*

49. Vendimi dhe urdhri i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

50. Nen i 8.8 i Aneksit II i të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuar në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.

51. Vendimi i Komisionit nuk paragjykon të drejtën e paraqitësve të kërkesës ose mbajtësve të së drejtës pronësore sipas rastit, për të kërkuar konfirmimin e te drejtave të tyre pronësore për pronat e kërkuara para autoriteteve kompetente vendore të tilla si autoritetet kadastrale apo gjykatat vendore, në përputhje me ligjin në fuqi.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligj i Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftim i i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

(a) Vendim i përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo

(b) Vendim i mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Gjykata Supreme mund të vjelë tarifën për procedurën e ankesës.

Informacione lidhur me procedurën e ankesave gjenden në fletën informuese për ankesën e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Version i në gjuhën angleze është version i zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron version i në gjuhën angleze**

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA07813	KPA15873 REP	KPA15909 REP	KPA13653	KPA42042	KPA42044	KPA23052
KPA50971	KPA06670					

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA54896 REP	KPA16491	KPA90130	KPA92863	KPA92864	KPA92865	KPA92866
KPA92867	KPA92868					